



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr.880 Prot.

Tiranë, më 05.05.2026

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për të garantuar të drejtën për një strehim të përshtatshëm për banorët e komuniteteve rome dhe egjiptiane në njësinë e banimit nr. 34, rruga “Fatmir Gjata”, Njësia Administrative nr. 11, Bashkia Tiranë.

BASHKISË TIRANË

Sheshi “Skënderbej”, nr.2
Tiranë

Për dijeni: **Znj. Manjola VEIZI**
Drejtoreshë Ekzekutive
Qendra për të Drejtat e Gruas Rome
Blloku i banimit “Garden City”
Godina 5, Njësia 5/9
Kthesa e Kamzës
Tiranë
Cel: 0696948040

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar², si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi, si dhe nga çdo formë sjelljeje që e nxit atë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “f”, të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), përcaktohet se: “Komisioneri ka kompetencë ... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja “c”, të LMD-së, ku përcaktohet se: “Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”, Komisioneri, në ushtrim të kompetencës që i jep LMD, me urdhrin nr. 82, datë 22.07.2025, ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes mbi situatën e strehimit të disa familjeve rome dhe egjiptiane në Njësia Administrative nr. 34, rruga “Fatmir Gjata”, Njësia Administrative nr. 11, Bashkia Tiranë.

I. Parashtrimi i fakteve lidhur me problematikën e marrë në shqyrtim.

Ky hetim administrativ i nisur nga Komisioneri bazohet në informacionin e përcjellë nga ana e Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome (QDGR).

Bazuar në informacionin e depozituar pranë Komisionerit, Qendra për të Drejtat e Gruas Rome (QDGR), parashtron se është një organizatë jofitimprurëse, e themeluar në shtator 2012 nga një grup grash rome aktiviste. Misioni i organizatës është të fuqizojë dhe mbështesë gratë dhe vajzat që përballen me diskriminimin dhe përjashtimin social, duke luftuar kundër të gjitha formave të shfrytëzimit dhe pabarazisë. Në këtë kudër, QDGR luan një rol aktiv në përfaqësimin dhe mbrojtjen e komuniteteve të marginalizuara përballë institucioneve publike.

QDGR, ka përcjellë pranë Komisionerit ankesën e disa banorëve dhe ish – banorëve të Njesisë së Banimit nr.34, rruga “Fatmir Gjata”, Njësia Administrative Nr.11, Tiranë, të cilët sipas saj po përballen me trajtim të pabarabartë në procesin e rindërtimit pas tërmetit të vitit 2019, si dhe me mungesë të theksuar të kushteve të jetesës dhe vëmendjes institucionale.

QDGR informon se, që prej tërmetit shkatërrues të 26 nëntorit, ka ndjekur dhe ka mbështetur në vazhdimësi situatën e familjeve të prekura, shumica e të cilave i përkasin komuniteteve rome dhe egjiptiane, me qëllim garantimin e të drejtës për strehim të sigurt dhe jetesë me dinjitet. Pavarësisht përpjekjeve nga vetë organizata, por edhe nga vetë banorët, QDGR shprehet se reagimi institucional ka qenë i munguar dhe i paorganizuar, me delegim të përgjegjësive nga një strukturë në tjetrën, pa ofruar ndonjë zgjidhje konkrete apo plan të qartë veprimi. Mosdhënia e përgjigjeve zyrtare nga Bashkia e Tiranës dhe institucionet qendrore, përfshirë Ministrinë e Rindërtimit, mbi fatin e ndërtesave dhe familjeve, përbën një heshtje institucionale të pajustificueshme dhe ngre shqetësime serioze për diskriminim sistematik mbi baza etnike dhe social ekonomike.

QDGR, parashtron në informacionin e saj se, ndërtesa nr. 34, një objekt i ndërtuar para vitit 1944, pësoi dëmtime serioze strukturore gjatë tërmetit dhe u klasifikua me shkallën më të rëndë të dëmtimit (DS5). Si pasojë, banorët u evakuuan, 7 familjeve të katit të dytë u është ndaluar rikthimi për shkak të rrezikut të shembjes, ndërsa banorët e katit të parë vijnë në jetojnë në ndërtesë, pavarësisht rrezikut të dokumentuar për jetën e tyre. QDGR, deklaroi se me asistencën e saj, një pjesë e familjeve aplikuan dhe përfituan bonusin e qirasë, por kjo nuk i ka shpëtuar nga vështirësitë serioze të vazhdueshme si, diskriminimi i hapur në tregun e qirasë për shkak të përkatësisë etnike, mungesa e banesave me standarde minimale të jetesës dhe vështirësi të theksuara ekonomike që rrezikojnë sigurinë e strehimit në vazhdimësi. Për më tepër, disa familje vijnë në jetojnë në godinën e dëmtuar, e cila përmbytet pas çdo reshje për shkak të mungesës së kanalizimeve funksionale dhe infrastrukturës rrugore.

Sipas QDGR, në këtë lagje banojnë rreth 100 familje, nga të cilat afro 40 i përkasin komuniteteve rome dhe egjiptiane. Këto familje janë të vendosura kryesisht në dy godina të amortizuara dhe të

pasigurta, me nr. 34 dhe 52. Infrastruktura e zonës ndodhet në gjendje të rënduar, kanalizimet janë të dëmtuara, rrugët të pashtruara dhe përmytjet janë të shpeshta gjatë sezonit të reshjeve. Më 30 prill 2021, në bashkëpunim me banorët, QDGR deklaroi se kanë paraqitur një kërkesë zyrtare për ndërhyrje infrastrukturore. Megjithatë, janë informuar nga bashkia se, për shkak të ndërtimeve pa leje dhe mungesës së fondeve, nuk është e mundur të kryhen ndërhyrje në këtë zonë.

QDGR, pretendon se, këto veprime përbëjnë një shkelje serioze të parimeve themelore të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht në fushën e të drejtës për strehim të sigurt dhe të denjë. Trajtimi i pabarabartë i familjeve rome dhe egjiptiane cenon dinjitetin dhe të drejtat e tyre themelore dhe thellon hendekun social-ekonomik, duke çuar në përjashtim të mëtejshëm dhe marginalizim afatgjatë. Përveç dështimit kronik të Bashkisë Tiranë për të garantuar ndër vite kushte minimale të strehimit dhe infrastrukturës publike, diskriminimi institucional është përkeqësuar edhe më tej përmes përjashtimit të këtyre familjeve nga fondi i rindërtimit, një instrument i konceptuar për të ndihmuar familjet e prekura nga tërmeti i vitit 2019. Mungesa e transparencës institucionale ka përkeqësuar situatën, duke i lënë familjet në pasiguri të plotë ligjore dhe sociale për më shumë se pesë vite, pa asnjë përgjigje zyrtare lidhur me fatin e godinës nr. 34. Aktualisht këto familje jetojnë në një ndërtesë të amortizuar dhe të pasigurt, duke rrezikuar jetën çdo ditë për shkak të gjendjes së saj strukturore

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri

Në zbatim të parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 32 e 33 të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë hapat si më poshtë për shqyrtimin e kësaj çështjeje:

1. Me shkresën nr. 587/3, datë 07.08.2025, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Bashkia Tiranë, në lidhje me çështjet e mëposhtme:
 - Sa është numri i personave (duke dhënë informacion në lidhje me gjeneralitetet e secilit prej tyre) që kanë banuar në Njësinë e Banimit nr. 34, rruga "Fatmir Gjata", Njësia Administrative Nr. 11, Bashkia Tiranë deri në momentin e tërmetit të datës 26 nëntor 2019? Cili ka qenë statusi i strehimit të banorë në këtë njësi banimi dhe a kanë qenë këta banorë pronarë të banesave? Nëse jo, cili ka qenë statusi i tyre në raport me banesat dhe prej sa vitesh kanë jetuar këta banorë në këto banesa?
 - Cili është statusi aktual i Njesisë së Banimit nr. 34, rruga "Fatmir Gjata", Njësia Administrative Nr. 11, Bashkia Tiranë (a është aktualisht e banueshme apo është shpallur e pabanuar si pasojë e tërmetit)? A ka persona që banojnë aktualisht në këtë godinë? Nëse po, sa është numri i tyre dhe mbi çfarë bazash banojnë në këtë njësi banimi në rast se ajo është shpallur e pabanueshme (duke dhënë informacion në lidhje me gjeneralitetet e secilit prej banorëve që vazhdojnë të jetojnë në ndërtesë)?
 - Informacion mbi kushtet e strehimit dhe gjendjen e infrastrukturës publike (rrugë, ndriçimi publik, kanalizime, ujë i pijshëm) ku jetojnë këta banorë?

- Çfarë masash ka ndërmarrë Bashkia Tiranë për zgjidhjen e çështjes së strehimit të familjeve që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, të cilët kanë banuar apo që vijnë të banojnë në Njësinë e Banimit nr.34, rruga “Fatmir Gjata”, Njësia Administrative Nr. 11 ?
- A janë trajtuar këta banorë, pas tërmetit të datës 26.11.2019, me programet e strehimit social? Nëse po, sa prej tyre kanë përfituar, llojin e programit të strehimit, kohëzgjatjen, dhe nëse vijnë të përfitojnë? Nëse ka banorë të cilët nuk trajtohen me ndonjë nga programet e strehimit, cilat janë arsyet/pengesat që këta banorë nuk janë trajtuar? Cila është situata aktuale e strehimit të banorëve të cilët nuk kanë përfituar nga ndonjë prej programeve të strehimit social?
- A ka Bashkia Tiranë ndonjë plan për investime në infrastrukturën publike të zonës, ku jetojnë këto familje? Nëse po, cilat janë investimet e parashikuara, fondet e planifikuara dhe afatet kohore për realizimin e tyre?
- A ka Bashkia Tiranë ndonjë plan për rindërtimin e njësisë së banimit nr. 34, në rrugën “Fatmir Gjata”, të Njësisë Administrative Nr. 11? Nëse po, cilat janë fondet e planifikuara dhe afatet kohore për realizimin e tyre? Në rast të një vendimmarrje për rindërtimin e njësisë së banimit nr. 34, a do të jenë këta banorë pronar të banesave, pavarësisht nëse posedojnë apo jo dokumentacion pronësor? Informacion në lidhje me gjendjen social - ekonomike të këtyre banorëve?
- Kopje të korrespondencës që është mbajtur me banorët, QDGR apo subjekte të treta, në lidhje me këtë problematikë?
- Sa prej banorëve janë trajtuar dhe kanë përfituar sipas njërit prej programeve të procesit të rindërtimit? Nëse po, lutem të specifikoni personat që kanë përfituar? Nëse jo, cilat janë arsyet dhe në çfarë faze janë aplikimet e tyre?

2. Me shkresën nr.27758/1 prot datë 22.8.2025, ka kthyer përgjigje Bashkia Tiranë (Drejtoria e Programeve Sociale dhe Monitorimit të Strehimit) ku ndër të tjera informon se:

Akti normativ nr.9/2019 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Këshillit të Ministrave, miratuar me ligjin nr. 97/2019, rregullon funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqsi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

Bashkia Tiranë, ka miratuar vendimin nr.129, datë 3.12.2029 të Këshillit Bashkiak “Për pagesën e plotë të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019”, i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar procedura për aplikim në funksion të trajtimit me pagesën e qirasë të individëve/familjeve të cilat janë prekur nga tërmeti i datës 19.11.2019.

Çdo muaj, Njësia Administrative nr.11 monitoron pagesën e qirasë dhe në muajin korrik rezulton se 7 individë/familje trajtohen në njësinë e banimit nr.34, rruga Fatmir Gjata sipas kërkesës nr. 3201/1

prot datë 29.7.2025. Ky numër është i ndryshueshëm çdo muaj në varësi të situatës së tyre në procesin e rindërtimit.

Nëpërmjet kësaj shkrese Bashkia Tiranë kërkon nga strukturat e tjera të saj si, Njësia Administrative nr.11, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve Ndaj Qytetarit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike, që për çështjet e tjera për të cilat është kërkuar informacion nga Komisioneri, të përcjellin informacionin që kërkohej.

3. Me shkresën nr. 27758/3 prot, datë 12.9.2025, Bashkia Tiranë (Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve Ndaj Qytetarit), informon se:

Në kuadër të rakordimit të informacionit, me Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike, pallati nr.34 rruga Fatmir Gjata, Njësia Administrative nr.11, ka kaluar për “Riaftësim strukturor”.

Nëpërmjet kësaj shkrese Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve Ndaj Qytetarit kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike, që për çështjet e tjera për të cilat është kërkuar informacion nga Komisioneri, të cilat janë në fushën e përgjegjësisë së kësaj drejtorie, të përcillet informacioni që kërkohej.

4. Me shkresën nr. 3201/3 datë 23.9.2025, Njësia Administrative nr.11, Bashkia Tiranë, ka informuar se:

Me anë të Akt Konstatimit më datë 1.10.2019 nga Instituti i Ndërtimit, pallati nr.34 është shpallur i degraduar dhe udhëzohet që të merren masat për evakuimin e menjëhershëm të banesave.

Sipas VKB nr.137, datë 6.12.2019, janë shpallur 7 fitues për programet e rindërtimit, të cilët ishin banorë të njësisë së banimit nr.34, rruga Fatmir Gjata, konkretisht: D.S.L; A. Xh. Xh; F. S.A; Sh.I. A; L.R.A; S.V.P; H.R.M.

Njësia Administrative me anë të shkresës nr.3116/1 prot datë 4.7.2022 ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale shkresën me lëndë “Dërgim dokumentacioni”, ku i bëjmë me dije se 1 nga banorët e njësisë nr.34 në rrugën Fatmir Gjata, konkretisht z.Xh. Xh, është orientuar drejt programeve të strehimit social dhe ka aplikuar pranë Njësisë Administrative nr.11. z. Xh. Xh ka refuzuar trajtimin me bonus qiraje.

5. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: “*Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar*”, për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 02.12.2025. Kjo seancë dëgjimore iu komunikua palëve me shkresën nr. 587/5 prot., datë 20.11.2025.

Seanca dëgjimore e datës 02.12.2025 u zhvillua me pjesëmarrjen e znj. Manjola Veizi, Drejtore Ekzekutive e Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome dhe përfaqësuesit të Njësisë Administrative Nr.11, z. Florian Zhupani. Në seancë dëgjimore nuk pati përfaqësues nga Bashkia Tiranë.

Gjatë seancës dëgjimore, znj.Veizi deklaroi se, si organizatë e kanë ngritur fillimisht këtë shqetësim në bashki. Një pjesë e banorëve kanë marrë bonus qiraje ndërsa një pjesë tjerë jetojnë ende tek godina nr.34. Për tre vite bashkia vetëm ka deleguar përgjegjësinë. Në këtë pallat jetojnë vetëm romë dhe egjiptianë. Znj. Veizi deklaroi se 10-12 familje kanë vijuar të banojnë dhe aktualisht banojnë në këtë ndërtesë.

Nga ana e përfaqësuesit të Njesisë Administrative Nr.11 u deklarua se, pas tërmetit është mbajtur një procesverbal ku pallati ka dalë i pabanueshëm. Ne si njësia administrative kemi dërguar aktin e ekspertimit të pallatit tek bashkia. Dijenja e bashkisë për situatën ekziston.

6. Me shkresën nr. 27752/7 prot., datë 24.12.2025, Bashkia Tiranë (Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike) informon se Bashkia Tiranë ka lidhur kontratën nr. 38773/2 datë 20.11.2025 për realizimin e akt-ekspertizës së thelluar me operatorin ekonomik “Taulant” SHPK, me afat realizimi 2 muaj kalendarik, pas të cilës do të vijohet me ndjekjen e procedurave për miratim teknik pranë Institutit të Ndërtimit.
7. Me shkresën nr. 471 prot., datë 02.03.2026, Komisioneri ka kërkuar informacion shtesë nga Bashkia Tiranë, duke kërkuar informacion në lidhje me çështjet e mëposhtme:
 - A ka përfunduar akt-ekspertiza e thelluar për “*Riaftësim strukturor i ndërtesës nr.3 4 (2-katesh), në rrugën “Fatmir Gjata”*”, sipas kontratës nr.38773/2 prot., datë 20.11.2025, të lidhur midis Bashkisë Tiranë dhe shoqërisë Taulant sh.p.k? Nëse po, në çfarë përfundimi është arritur në lidhje me godinën, duke depozituar një kopje të kësaj akt-ekspertizës.
 - Nëse akt-ekspertiza e thelluar ka përfunduar, në çfarë faze është aktualisht procesi për dorëzimin dhe miratimin e saj pranë Institutit të Ndërtimit? Informacioni duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit përkatës provues.
 - A ka Bashkia Tiranë ndonjë plan në lidhje me mënyrën se si do të sigurohet strehimi i familjeve që nuk trajtohen nga programet e strehimit social, por vijnë aktualisht të jetojnë në këtë ndërtesë?
 - Informacion mbi gjendjen e infrastrukturës publike (rrugë, ndriçimi publik, kanalizime, ujë i pijshëm) në zonën ku jetojnë këta banorë?
 - Çfarë investimesh në infrastrukturë publike ka realizuar Bashkia Tiranë në këtë zonë në 5 vitet e fundit?
 - A ka Bashkia Tiranë ndonjë plan për investime në infrastrukturën publike të zonës, ku jetojnë këto familje? Nëse po, cilat janë investimet e parashikuara, fondet e planifikuara dhe afatet kohore për realizimin e tyre?
8. Me shkresën nr. 8760/1 prot., datë 10.03.2026, Bashkia Tiranë (Drejtoria e Programeve Sociale dhe Monitorimit të Strehimit) informon se, në muajin shkurt 2026, 7 individë/familje në njësinë e banimit nr. 34 trajtohen me pagesë qiraje. Bashkia sqaron se familjet e pastreha trajtohen sipas programeve sociale të strehimit të parashikuara në Ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social". Nëse banorët e këtij pallati plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për të përfutur nga programet e strehimit social sipas këtij ligji, asistohen nga njësia administrative përkatëse mbi programin

që adreson nevojat e familjes së tyre, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe informimin e qytetarëve.

9. Me shkresën nr. 8760/2 prot., datë 19.03.2026, Bashkia Tiranë (Drejtoria e Koordinimit dhe Bashkërendimit të Rindërtimit) informon se Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Subjekteve Përfituese nga Programet e Procesit të Rindërtimit ka konstatuar se praktikrat e pallatit nr. 34 janë pjesë e pallateve me nivel dëmi DS4, pallate të cilat janë dërguar për hartimin e akt ekspertizës së thelluar, si edhe për hartimin e projektit për të cilat do të kryhen punimet për riparimin e dëmeve nga strukturat e tjera përgjegjëse pranë Bashkisë Tiranë. Në këtë përgjigje theksohet se, Komisioni i Posaçëm nuk mund të vijonte me shqyrtimin e praktikës së pallatit dhe e ka kthyer atë pranë Drejtorisë së Koordinimit dhe Bashkërendimit të Rindërtimit, me anë të shkresës nr.23431, datë 27.07.2025, e cila e ka përcjellë këto praktika pranë Njesisë Administrative Nr.11, për administrim të mëtejshëm, me anë të shkresës nr.25431/6, datë 25.07.2025.
10. Me shkresën nr. 1440 prot., datë 25.03.2026, Njësia Administrative nr. 11 informon se është në zbatim projekti "Rikualifikimi Urban i Zonës Mbrapa Pallateve të Vjetra Rr. E Balshajve", në të cilin është parashikuar zgjerimi dhe asfaltimi i Rr. "Fatmir Gjata".
11. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 13.04.2026, znj. Manjola Veizi, përfaqësuese e Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome, parashitroi se:

“Sikurse ka ndodhur edhe me komunikimet e mëparshme që ne si QDGR kemi pasur me Bashkinë Tiranë, vihet re se ata kufizohen në përcjelljen e shkresave pa kthyer përgjigje konkrete për pyetjet e ngritura.

Nga komunikimi i datës 19.03.2026 rezulton se asnjë nga familjet banore të pallatit nr. 34 (listuar në listat e dërguara) nuk ka përfituar nga programi i rindërtimit. Dy familjet e përmendura aty, Kaloshi dhe Peraj, nuk kanë lidhje me pallatin nr. 34. Vlen të theksohet se në komunikimet e bëra gjatë vitit 2025(shiko listen), këta banorë janë klasifikuar me dëmtime DS5, ndërsa në komunikimet e fundit janë cilësuar si DS4. Në fakt, banorët disponojnë fletëvlerësimi individuale me klasifikim DS5, çka ngre dyshime mbi këtë ndryshim të fundit. Aktualisht mbetemi në të njëjtën situatë, pa asnjë informacion konkret. Po ashtu, nuk është dhënë asnjë përgjigje lidhur me vlerësimin e gjendjes së objektit nga kompania e kontraktuar, pavarësisht se kërkesa juaj i ka pyetjet shumë të qarta dhe të drejtpërdrejta. Sa i përket shkresës së dytë, ajo nuk ka lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Bëhet fjalë për një proces të përgjithshëm që ka nisur në të gjithë zonën, lidhur me rehabilitimin e rrugëve, përfshirë edhe rrugën “Fatmir Gjata”.

III. Legjislacioni dhe standardet e zbatueshme.

Kushtetuta e Shqipërisë në kreun për objektivat sociale, neni 59 parashikon ndër të tjera se shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim. Ky formulim kushtetues

mund të interpretohet se Kushtetuta nuk parashikon një të drejtë të përgjithshme për strehim, në kuptimin që shteti është i detyruar në terma absolute për ta realizuar këtë të drejtë. Megjithatë në interpretim të nenit 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara janë të pjesë e sistemit të brendshëm juridik, janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe kanë epërsi ndaj ligjeve të vendit që nuk pajtohen me të.

E drejta ndërkombëtare e njeh të drejtën për strehim të përshtatshëm, si pjesë përbërëse thelbësore të një standardi të përshtatshëm jetese. Kjo është një e drejtë e cila nuk mund të kufizohet vetëm te pasja e në çatie ose strehe, por duhet interpretuar si e drejta që njeriu të ketë një vend ku mund të jetojë në siguri, paqe dhe dinjitet.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në nenin 25 paragrafi 1, parashikon të drejtën e çdokujt për një standard të përshtatshëm jetese, përfshi të drejtën për një strehim të përshtatshëm.

Neni 11 paragrafi 1, i *Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*, deklaron se çdokush ka të drejtë për një standard të përshtatshëm jetese për veten dhe familjen e tij, përfshi, ushqim, veshmbathje dhe strehim të përshtatshëm dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës.

Në Komentin e Përgjithshëm nr. 4 “*Për të drejtën për një strehim të përshtatshëm*”, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, struktura e Kombeve të Bashkuara e krijuar për monitorimin e zbatimit të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, shprehet se, e drejta për strehim nuk duhet barazuar me pasjen e një çatie mbi kokë, por ajo duhet parë si e drejtë për të jetuar diku në siguri, paqe dhe dinjitet. Komiteti për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore, thekson gjithashtu se, e drejta për strehim u duhet garantuar të gjithë personave, pavarësisht të ardhurave të tyre, dhe duhet zbatuar në një mënyrë të tillë që të përputhet me mundësitë e tyre. Strehimi është i lidhur ngushtë edhe me praninë e një sërë shërbimesh, që përfshijnë aksesin në ujin e pijshëm, energjinë për gatim, ngrohje dhe ndriçim, lehtësira hidro-sanitare, vend për hedhjen e mbeturinave, sistem kullimi etj. Individët duhet të kenë mundësi të paguajnë koston e jetesës në një banesë të përshtatshme dhe duhet që atyre t'i krijohet mundësia edhe përmes programeve të banesave sociale, nëse nuk kanë mundësi për të përballuar kostot e një banese. Po ashtu qiramarrësit duhet të mbrohen nga rritjet e paarsyeshme të çmimeve të qirave.

Sipas Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që të garantojnë se grupeve vulnerabël si romëve¹/udhëtarëve u duhen ofruar mundësi të përshtatshme për të rregulluar strehimin e tyre dhe mos marrja në konsideratë e nivelit të tyre të mohimit përgjatë viteve kur hartohen kërkesat e nevojshme për rregullimin e strehimit mund të çojë në diskriminim të tërthortë.

¹ Termi “rome” përdoret si term ombrellë, i cili përfshin edhe egjiptianët

Koncepti i banesës së përshtatshme do të thotë që banesat të kenë hapësirë të mjaftueshme dhe t'i garantojë banorëve sigurinë fizike dhe t'i mbrojë nga të ftohtit, lagështira, nxehtësia, shiu, era etj. Banesat duhet të jenë në vende që i lejon akses në punësim, shërbime shëndetësore, shkolla, qendra të perkujdesit të fëmijëve etj.

Sipas Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, shtetet kanë detyrimin minimal, pavarësisht nga niveli i zhvillimit të tyre ekonomik, për të njohur, respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtën për strehim të përshtatshëm. Sigurisht që këto të realizohen duhen të garantohen fonde publike të mjaftueshme në mënyrë që të arrihet progresivisht realizimi i plotë i të drejtës për strehim të përshtatshëm, përmes gjithë mjeteve të duhura, dhe në maksimum të burimeve që ka në dispozicion.

Realizimi progresiv i të drejtës shpesh keqinterpretohet si leje për të shtyrë pafundësisht realizimin e të drejtës. Realizimi progresiv jo domosdoshmërisht do të thotë rritje burimesh materiale dhe financiare, por mund të jetë edhe një përdorim më efektiv i burimeve ekzistuese. E drejta për mosdiskriminim nuk i nënshtrohet realizimit progresiv por është një detyrim me efekt të menjëhershëm.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor (neni 5 e/iii) e ndalon diskriminim racor, për gëzimin e të drejtës për strehim. Në Rekomandimin e përgjithshëm nr. 27 kundër diskriminimit ndaj Romëve², të miratuar nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial, ndër të tjera shtetet rekomandohen për marrjen e masave të mëposhtme:

- Të zhvillojë dhe zbatojë politika dhe projekte të cilat synojnë mënjanimin e veçimit të komuniteteve rome sa i takon strehimit; të përfshijë komunitetet dhe shoqatat rome si partnerë bashkë me të tjerët në projekte për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e shtëpive.
- Të veprojë me vendosmëri kundër çdo praktike diskriminuese që prek romët, kryesisht nga autoritetet lokale dhe pronarë privatë, për të marrë banesë dhe mundësi strehimi; të veprojë me vendosmëri ndaj çdo mase që i mohon banesën ose dëbimin e paligjshëm të romëve dhe të mos i vendosin romët në kampe, në zona të cilat janë të izoluara dhe pa mundësi akses në shërbimet shëndetësore dhe lehtësira të tjera.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (neni 14 (2/e) dhe 15 (2)), parashikon detyrimin e shteteve palë që të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në zonat bujqësore me qëllim që të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, pjesëmarrjen e saj në zhvillimin e fshatit dhe njëherësh në avantazhet që sjell ajo. Në mënyrë të veçantë ato i sigurojnë gruas, të drejtën për të pasur kushte jetese të përshtatshme, sidomos lidhur me strehimin, shërbimin sanitar, furnizimin me energji elektrike dhe ujë, transportin dhe komunikacionet.

² CERD, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 27 *Mbi Diskriminimin Kundër Romëve*, miratuar në Sesionin e esëdhjetë e shtatë të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Racor, më 16 gusht 2000.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për strehim të përshtatshëm si një të drejtë të veçantë, por mbrojtja e kësaj të drejte rrjedh nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) në kuadër të garantimit të të drejtave të tjera, si e drejta për jetë private dhe familjare apo e drejta për të gëzuar lirisht pronën.

Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;
- b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;
- c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;
- d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Rekomandimi (2005)4 “Për Përmirësimin e Kushteve të Strehimit të Romëve dhe Udhëtarëve në Evropë”, miratuar me 23 shkurt 2005, nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, iu kërkon shteteve anëtare, që meqenëse romet, vazhdojnë të mbeten ndër grupet më shumë të disavantazuara në Evropë, politikat kombëtare të strehimit duhet të adresojnë problemet e tyre specifike si çështje emergjence dhe në mënyrë jodiskriminuese.

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), në Rekomandimin Nr. 13 “Për Luftën Kundër Anti-Ciganizmit dhe Diskriminimin Kundër Romëve”, miratuar me datë 24 qershor 2011³, kërkon nga shtetet që të luftojnë anti-ciganizmin në lidhje me strehimin dhe të drejtën për respektimin e shtëpisë së tyre, përkatësisht:

- t’u ofrojnë mundësi romëve të kenë strehim të denjë;
- të luftojnë ndarjen de facto, ose të detyruar lidhur me strehimin;
- të sigurojnë se ofrimi i shtëpive sociale për romet u vjen në ndihmë integritetit të tyre dhe të mos i mbajë ata të ndarë;
- të sigurojnë që romët nuk dëbohen pa njoftim paraprak dhe pa iu dhënë atyre mundësinë e një strehimi tjetër me kushte të denja;

Raporti i ECRI-i për Shqipërinë⁴, i datës 7 prill 2020, përsërit rekomandimin e tij që, autoritetet përgjegjëse shtetërore duhet të sigurojnë që të gjithë romët dhe egjiptianët, si çdo person tjetër, të gëzojnë të gjitha garancitë që parashikojnë aktet ligjore ndërkombëtare në lidhje me strehimin. Në

3 Rekomandimi sqaron se termi "romë" përfshin jo vetëm romët, por edhe sintit, kalit, ashkalinjtë, egjiptianët, monushet, dhe grupe të tilla të ngjashme popullsisht, së bashku me endacakët, në mënyrë që të përqafohet diversiteti i madh i grupeve në fjalë.

⁴ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-i-ECRI-t-për-Shqipërinë.pdf>

veçanti, shtesat vulnerabël duhet të përfitojnë nga mbrojtja e duhur ligjore dhe të kenë mundësinë e strehimit në një banesë të përshtatshme. Raporti i sipërcituar në pikat 53-54, të tij përcakton se:

“Situata e strehimit është ende jashtëzakonisht e vështirë për shumë romë dhe egjiptianë në Shqipëri. Përveç kushteve shpesh shumë të dobëta, mungesa e përhapur e titujve të pronësisë ose marrëveshjeve të sigurta të qiramarrjes i bën shumë anëtarë të këtij komuniteti të prekshëm nga dëbimet. Me rritjen e zhvillimit ekonomik në Shqipëri, romët dhe egjiptianët që jetojnë në banesa joformale kanë qenë nën presion për t'i braktisur vendbanimet e tyre, në disa raste duke u dëbuar shumë herë nga vende të ndryshme, pa qasje të lehtë në zgjidhje alternative dhe të përhershme të strehimit. Duke pasur parasysh që kërkesa e përgjithshme për strehim social në vend tejkalon ofertën, kjo zakonisht nuk është një zgjidhje e menjëhershme, përveç një numri të vogël të personave të prekur. Sidoqoftë, shumë romë dhe egjiptianë preferojnë, ose edhe insistojnë, të qëndrojnë së bashku në grupet e tyre të krijuara, të cilat jo vetëm që përbëjnë një identitet kulturor për ta, por janë edhe rrjete të rëndësishme mbështetëse për të përballuar më mirë varfërinë dhe efektet e marginalizimit shoqëror.

Në raportin e tij të mëparshëm, ECRI rekomandoi që:

- (i) autoritetet të forcojnë përpjekjet e tyre për të rregulluar strehimin e paligjshëm për romët dhe egjiptianët;
- (ii) (ii) personat e dëbuar nga shtëpitë e tyre të gëzojnë të gjitha garancitë e dhëna nga standardet përkatëse ndërkombëtare (njoftim paraprak, mbrojtje të përshtatshme ligjore, disponueshmëri të banesave alternative);
- (iii) (iii) akses me përparësi për strehim social, duke u reformuar në mënyrë që të përfshijë më mirë personat e prekur nga prishja e banesave/dëbimeve”.

Ndër të tjera në pikën 58, të tij, citohet se: “ECRI përsërit rekomandimin e tij që autoritetet të sigurojnë që të gjithë romët dhe egjiptianët, si dhe çdo person tjetër, të cilët mund të dëbohen nga shtëpitë e tyre, të gëzojnë të gjitha garancitë që parashikojnë tekstet ndërkombëtare në lidhje me këtë. Në veçanti, ata duhet të njoftohen paraprakisht për dëbimin e planifikuar dhe të përfitojnë nga mbrojtja e duhur ligjore; dhe ata nuk duhet të dëbohen pa pasur mundësinë e ristrehimit në një banesë të përshtatshme. Për më tepër, ECRI rekomandon që autoritetet të ndërmarrin veprime për të parandaluar çdo përdorim të forcës së paligjshme, të panevojshme ose të tepruar gjatë dëbimeve”.

Direktiva e Bashkimit European 2000/43/Këshillit Evropian, e 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”. nuk e përkufizon të drejtën për strehim të përshtatshëm. Megjithatë kjo Direktivë sugjeron që interpretimi të bëhet sipas të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në veçanti të drejtës për respektimin e banesës (sipas nenit 7 të Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore dhe Nenit 8 të KEDNJ-së), dhe të drejtës për strehim të përshtatshëm (sipas nenit 11 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike dhe Social Kulturore).

Në kuadrin ligjor kombëtar, e drejta për strehim të përshtatshëm, gjen rregullim në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse. Një nga parimet e këtij ligji është parimi i mosdiskriminimit, i parashikuar nga neni 10, sipas përmbajtjes vijuese: “1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese.....”.

Në Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve (PKVBPPR) në Republikën e Shqipërisë (2021-2025), sikurse edhe PKVBPPR paraardhës (2016-2020), parashikohet marrja e masave të nevojshme nga ana e shtetit shqiptar lidhur me çështjen e strehimit të pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane. Në pikën 3/7 “Parimet Themelore”/ “Promovimi i lidhjeve ndërsektoriale” – Plani i Veprimit (2021-2025) trajton nevojat për këto pakica kombëtare në një sërë fushash kyçe, duke përfshirë: arsimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integrimi urban, punësimin dhe arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale dhe regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, me synim nxitjen e integritetit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Në Rubrikën 4 “Kushtet Aktuale dhe Sfidat”, të këtij Plani⁵ citohet se: *Situata e strehimit është ende e vështirë për shumë anëtarë të minoritetit Rom dhe Egjiptianë në Shqipëri. Përveç kushteve shpesh shumë të rrënuara, mungesa e titujve të pronësisë ose marrëveshjeve të sigurta të qiramarrjes i bën shumë anëtarë të këtij komuniteti të prekshëm nga dëbimet. Shumë njerëz ngritën banesat e tyre në tokë publike të papërdorur edhe në pronë, pronësia e së cilës mbetet e paqartë pas rënies së komunizmit në fillim të viteve 1990. Sipas të dhënave të Sondazhit Rajonal për Komunitetin Rom, 84% e komunitetit Rom kanë akses në elektricitet dhe 50% e anëtarëve të minoritetit Rom kanë akses në ujë të pishëm në banesat e tyre krahasuar me shifrën 89% që i takon fqinjëve jo-Romë.”*

Në Pjesën II – Qëllimet e Politikave dhe Objektivat Specifikë/ Qëllimet Strategjike të PKVBPPRE 2021-2025, pika 2, të Planit të Veprimit (2021-2025) parashikohet se një ndër qëllimet strategjike më të rëndësishme të këtij plani është edhe përmirësimi i kushteve të strehimit për anëtarë të Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve jo formale. Objekti Specifik 1, i këtij qëllimi strategjik përcakton shprehimisht rritjen e numrit të përfituesve romë dhe egjiptianë nga çdo program strehimi. Në elaborimin që i bëhet këtij objekti citohet: “Anëtarë të komunitetit Rome dhe Egjiptianë vazhdojnë ende të përballen me vështirësi për sa i takon çështjeve të strehimit. Këtu përfshihen vështirësitë në aplikimin për strehim social. Në më të shumtën e rasteve

⁵ Referuar faqes 12, të Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve & Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025);

ka mungesa në burimin e verifikueshëm të të ardhurave dhe dokumenteve të tjera si dhe procedurat janë të ndërlikuara. Kjo situatë e vështirë shoqërohet edhe me mungesën e strehëve të përkohshme (si, Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencave) dhe mungesës së alternativave afatgjata dhe e zgjidhjeve të qëndrueshme të strehimit për këto komunitete. Mbështetja me ndihmë ligjore falas për anëtarët e Minoritetit Rom dhe Egjiptian për problemet që ata mund të hasin gjatë procesit të përfundimit të legalizimit është domosdoshmëri. Shumë familje rome dhe egjiptiane jetojnë në objekte të paprivatizuara ende si: ish-ndërmarrje, pulari, pallate etj, ose i kanë nisur procedurat dhe nuk i kanë përfunduar ato, pra nuk zotërojnë titujt e pronësisë së vendbanimit... ”.

Në Kreun III, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Në nenin 20, pika 1 dhe pika 2, germa “d”, të LMD parashikohet: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi. 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:d) sistemimin në një vend ku ofrohet strehim.....”

Neni 18, i Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, sanksionon: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021).

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur

individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (*Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese*).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁶. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁷. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14⁸.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”

LMD, është një ligj i cili është miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 18, të Kushtetutës. Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Neni 6, i LMD, përcakton: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të*

⁶ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁷ Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

⁸ Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Neni 3, pika 6, i LMD-së, përcakton se: *“Diskriminim strukturor” është ajo formë diskriminimi që u referohet rregullave, normave, praktikave, modeleve të qëndrimeve dhe sjelljeve në institucione dhe në struktura të tjera shoqërore, që në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme paraqesin pengesa për grupet ose individët për të pasur të njejta të drejta dhe mundësi si të tjerët dhe që kontribuojnë në rezultate më pak të favorshme për ta në raport me të tjerët.*” Diskriminimi strukturor priret të mos jetë produkt i veprimit të qëllimshëm, por i sistemeve dhe strukturave nëpërmjet të cilave institucioni ushtron funksionet e tij, si politikbërës dhe ofrues shërbimesh. Përgjegjësia për këtë formë diskriminimi nuk është individuale, por i takon kryesisht shtetit dhe institucioneve të tij. Në kontekstin konkret, pasiviteti i zgjatur i Bashkisë Tiranë në drejtim të sigurimit të strehimit të përshtatshëm për familjet rome dhe egjiptiane të pallatit nr. 34 përbën një manifestim të diskriminimit në formën strukturore.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i rregullimit të veçantë sipas LMD. Bazuar në nenin 33, pika 7/1, të LMD, sanksionohet se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojnë se faktet nuk përbejnë diskriminim”.* Për analogji me rastin konkret, informacioni i administruar gjatë hetimit, përqendrimi i familjeve rome dhe egjiptiane në një ndërtesë të rrezikshme për mbi 6 vite pas tërmetit, mungesa e përfshirjes në programet e rindrimëtimit dhe e investimeve në infrastrukturën bazë, përbën një prezumim të diskriminimit për shkak të etnisë. Në kushtet e këtij prezumimi, Bashkia Tiranë do të duhej të ofronte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për mospërfshirjen e këtyre familjeve në zgjidhjet afatgjata të strehimit, justifikim të cilin nuk e ka ofruar.

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD), në observacionet përfundimtare të datës 23.05.2024, mbi raportet periodike 13 dhe 14 të kombinuara të Shqipërisë, theksoi se shumë romë dhe egjiptianë vazhdojnë të jetojnë në kushte të pasigurta, pa qasje në shërbime bazë si ujë i pij shëm, kanalizime dhe energji elektrike, si dhe pa siguri ligjore mbi banesat e tyre. Në këto rrethana, CERD rekomandoi që shteti sh qiptar: (a) të miratonë masa të përshtatshme për të siguruar qasje në strehim adekuat, me konsultim të vërtetë të komuniteteve të prekura; (b) të vazhdojë përpjekjet për qasje në shërbime bazë; dhe (c) të sigurojë siguri ligjore të banimit dhe mbrojtje efektive. Këto gjetje të CERD-it konfirmojnë se situata e banorëve të pallatit nr. 34 të Bashkisë Tiranë është pjesë e një problematike më të gjerë dhe sistematike të strehimit të pakicave rome dhe egjiptiane në Shqipëri, e dokumentuar nga organet ndërkombëtare të monitorimit.

Në ushtrimin e kompetencave të tij, Komisioneri ka konstatuar më parë diskriminim në raste të ngjashme. Në vendimin nr. 126, datë 20.06.2022, Komisioneri konstatoi diskriminimin e 36 familjeve që i përkasin pakinës kombëtare egjiptiane, banuese në godinën e ish-Ndërmarrjes së Grumbullimit Kavajë, nga ana e Bashkisë Kavajë, për shkak të kushteve të papërshtatshme të jetesës dhe mosveprimit institucional në sigurimin e strehimit social. Në këtë vendim Komisioneri theksoi se mosveprimi për sigurimin e strehimit për kategoritë vulnerabël përbën diskriminim, pavarësisht nëse ekziston ose jo një vendim formal për përjashtim. Situata e banorëve të pallatit nr. 34, Bashkia

Tiranë, përmbush të njëjtat elemente: përkatësi në pakicën kombëtare rome dhe egjiptiane, kushte banimi të pasigurta për një periudhë të zgjatur dhe mungesë e një zgjidhjeje afatgjate institucionale. E drejta për mosdiskriminim nuk i nënshtrohet realizimit progresiv, por përbën një detyrim me efekt të menjëhershëm.

IV. Konkluzione.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 18, garanton parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, ndërsa neni 59 synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim, dhe kur instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të ratifikuara nga Shqipëria, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolli 12 i saj, si dhe instrumentet e Këshillit të Evropës, parashikojnë të drejtën për strehim të përshtatshëm si pjesë të standardit të një jete të denjë dhe kërkojnë masa konkrete për eliminimin e diskriminimit ndaj romëve në fushën e strehimit, Bashkia Tiranë ka detyrim ligjor dhe kushtetues për të siguruar kushte strehimi dhe infrastrukturë bazë, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim ndaj komunitetit rom.

Komisioneri vlerëson se, mbi bazën e fakteve të konstatuara dhe legjislacionit të zbatueshëm, familjet rome dhe egjiptiane të Njesisë së Banimit nr. 34, rruga "Fatmir Gjata", Njësia Administrative nr. 11, Bashkia Tiranë, vazhdojnë të jetojnë në kushte të rrezikshme dhe të papërshtatshme, pavarësisht kalimit të mbi gjashtë viteve nga tërmeti i nëntorit 2019.

Komisioneri konstaton se ndërtesa nr. 34 është klasifikuar fillimisht me shkallën DS5 - nivel dëmi maksimal - që prej tërmetit të 26 nëntorit 2019. Nga informacioni i Bashkisë Tiranë, konstatohet se në vitin 2025 kjo ndërtesë ka kaluar nga niveli maksimal i dëmtimit DS5 në një nivel më të ulët dëmtimi DS4. Nga ana e Bashkisë Tiranë nuk u ofrua informacion në lidhje me këtë ndryshim. Nga aktet e administruara rezulton se procesi i rikualifikimit të ndërtesës nga DS5 në DS4 është bërë në mungesë të plotë të bashkëpunimit dhe transparencës me banorët e kësaj ndërtese. Aktualisht pallati ndodhet në fazën e akt-ekspertizës së thelluar, kontratë e lidhur vetëm më 20.11.2025, gjashtë vite pas tërmetit. Familjet vijojnë të jenë të vendosura ose në ndërtesën e dëmtuar ose të shpërndara me bonus qiraje, pa një zgjidhje afatgjatë dhe të qëndrueshme.

Komisioneri konstaton se, për aplikantët e njesisë nr. 34 që nuk plotësojnë kushtet për të vijuar me pagesën e qirasë sipas legjislacionit në fuqi, Bashkia Tiranë nuk ka paraqitur asnjë plan konkret për sigurimin e strehimit alternativ afatgjatë për këto familje që i përkasin komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian.

Komisioneri konstaton se infrastruktura publike e zonës ku jetojnë familjet e prekura mbetet e dëmtuar dhe e papërmirësuar. Kanalizimet janë jo funksionale, rrugët të pashtuara dhe zona përmytet pas rreshjeve, pretendime këto që nuk u kundërshtuan nga Bashkia Tiranë. Edhe pse

Bashkia Tiranë ka njoftuar se janë planifikuar disa punë infrastrukturore sipas projektit "Rikualifikimi Urban i Zonës Mbrapa Pallateve të Vjetra", ende nuk ka filluar zbatimin i masave konkrete për zgjidhjen e problemeve urgjente.

Komisioneri vlerëson se mungesa e vëmendjes institucionale ndaj familjeve rome dhe egjiptiane të pallatit nr. 34, krahasuar me banorët e tjerë të dëmtuar nga tërmeti, ngre shqetësime serioze për diskriminim ndaj tyre mbi bazë etnie. Mëzbatimi i programit të rindërtimit apo gjetja e alternativave strehimi, për familjet me nivel dëmi DS5 dhe DS4 prej pallatit nr. 34, rruga "Fatmir Gjata", ku dominojnë familjet rome dhe egjiptiane, ndërkohë që procesi i rindërtimit për ndërtesa të tjera ka përparuar, përbën trajtim dallues që duhet të justifikohet me arsye objektive dhe të arsyeshme. Bashkia Tiranë nuk ka ofruar ndonjë justifikim të tillë.

Komisioneri vlerëson se, në kuadër të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, si dhe të Aktit Normativ nr. 9/2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Bashkia Tiranë duhet të ndërmarrë masa konkrete dhe të menjëhershme për garantimin e strehimit të denjë të familjeve rome dhe egjiptiane të prekura dhe për investimet e nevojshme në infrastrukturën publike të zonës.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllim rregullimin e situatës dhe bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja "f", të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar,

R E K O M A N D O N:

- Bashkia Tiranë duhet të ndërmarrë menjëherë masa konkrete dhe efektive për të siguruar zgjidhjen afatgjatë dhe të qëndrueshme të strehimit për familjet rome dhe egjiptiane të njësisë së banimit nr. 34, rruga "Fatmir Gjata", Njësia Administrative nr. 11, duke trajtuar kjo problematikë si prioritet.
- Bashkia Tiranë duhet të marrë masa urgjente për përshpejtimin e procesit të riaftësimit strukturor të pallatit nr. 34, duke siguruar që akt-ekspertiza e thelluar e lidhur me kontratën nr. 38773/2, datë 20.11.2025, të përfundojë sipas afateve dhe të pasohet menjëherë nga procedurat e nevojshme për miratim pranë Institutit të Ndërtimit dhe fillimin e punimeve të riparimit.
- Bashkia Tiranë duhet të hartojë dhe zbatojë një plan konkret veprimi për familjet e pallatit nr. 34 që nuk trajtohen me bonus qiraje dhe nuk kanë akses të garantuar ndaj programeve sociale të strehimit, duke garantuar që asnjë familje rome ose egjiptiane të mos mbetet pa zgjidhje strehimi gjatë procesit të riaftësimit të ndërtesës.
- Bashkia Tiranë duhet të ndërhyjë me investime emergjente në infrastrukturën publike të zonës ku jetojnë familjet e prekura, duke siguruar sistemin e kanalizimeve, rrugëve dhe ndriçimit publik, si dhe eliminimin e rrezikut të përmytjeve, si kushte minimale të jetesës.
- Bashkia Tiranë duhet të garantojë përfshirjen aktive dhe transparente të komunitetit rom dhe egjiptian të zonës në të gjitha fazat e procesit vendimmarrës lidhur me strehimin dhe infrastrukturën, nëpërmjet konsultimeve të rregullta.

Bashkia Tiranë duhet të raportoje, brenda 30 ditëve nga marrja e dijeni, mbi masat e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Robert GAJDA